VENDIM
Nr. 324, datë 14.11.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË 13.3.2023, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'SUNPOWER 2017' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/12 prot., datë 10.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.3.2023, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Sunpower 2017' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw"',

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 73, datë 13.3.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë "Sunpower 2017" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar, duke i lënë kushtin që të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj mbi fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 22.4.2024.
- ERE, me shkresën me nr. 134/9 prot., datë 16.3.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 73/2023 dhe me shkresën me nr. 134/10 prot., datë 16.6.2023, i kujtoi asaj detyrimin për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s.
- Në korrespondencën e zhvilluar me shoqërinë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti, ajo ka informuar ERE-n se është pajisur me lejen e ndërtimit.
- Më tej, në përgjigje të shkresës së ERE-s të datës 7.11.2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2056/10 prot., datë 8.11.2023, shoqëria ka informuar se në fund të muajit tetor 2023 ka filluar fazën e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik.
- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2023, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.
- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2023 shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Sunpower 2017" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që

mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti